



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 155 /2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër Avdullah Hoxha anëtar të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në Raundin e dytë për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 30.05.2012, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 28.05.2012, nga subjekti politik LDK, me të cilën pretendohet se Avdullah Hoxha dhe Ibush Bakolli bashkë me disa anëtarë, aktivistë të subjektit politik PDK, e kanë penguar procesin zgjedhor. Ankuesi në ankesë potencon se ata, votuesit i kanë ftuar publikisht që të votojnë për PDK-në, kandidatin e tyre. Sipas parashtresit të ankesës është bërë shkelja e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Ankuesi në ankesë pretendon se aktivistët e PDK-së Avdullah Hoxha dhe Ibush Bakolli, bashkë me disa anëtarë, kanë penguar procesin zgjedhor, duke i ftuar votuesit që të votojnë për kandidatin e subjektit politik PDK. PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë për faktin se në ankesë nuk janë dhënë prova dhe dëshmi të cilat eventualisht do ti argumentonin pretendimet e tilla

ankimore, andaj duke marr parasysh këtë, në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe nenit 3 paragrafi 6 pika "c" të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 155 /2012 më datën 30.05.2012.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

